

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 6 TETOR 2022

Zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot diskutojmë një marrëveshje me qeverinë e Japonisë në fushën e kulturës, që, pa dyshim, meriton mirënjohjen e të gjithëve për mbështetjen që ka dhënë qeveria e Japonisë jo vetëm në këtë marrëveshje, por edhe në fusha të ndryshme që ka me shtetin shqiptar. Ndërkohë që ne diskutojmë këtë marrëveshje në Kuvend, prej javësh pedagogët janë në protestë, janë të detyruar të dalin në rrugë, sepse keqpaguhën, sepse nuk trajtohen me dinjitet, dhe në vend që të dëgjoheshin për kërkesat e tyre të drejta, edhe pse, në këndvështrimin tim, janë tepër të vonuara, dhe të merrnin një zgjidhje nga kjo qeveri, u përballën me arrogancën dhe me injorimin e kërkesave të tyre qoftë nga Ministria e Arsimit, qoftë nga Kryeministri.

Çfarë është kjo qasje? Ata nuk janë armiq, janë shtresa më intelektuale e vendit, e cila është e detyruar të dalë në rrugë për të kërkuar një pagë dinjitoze sa ajo e Kosovës. Nuk po kërkojnë qiqra në hell, por kërkojnë një pagë sa ajo e Kosovës, jo sa Mali i Zi, jo sa Kroacia, pa folur për vendet e BE-së, ndërkohë që qasja është sikur janë armiq të këtij vendi, kur në realitet janë një shtresë, që po na vë alarmin, se mund të largohen nga ky vend nëse nuk do të trajtohen me dinjitet, ashtu siç bëjnë shumë të rinj, fatkeqësisht, shumë intelektualë që po largohen nga ky vend. Dje, në ditën Ndërkombëtare të Mësuesve qeveria u tall me ta, duke u thënë në mënyrë përçmuese që do t'ua rriste 7% rrogën, kur ata përballen me kosto të larta të jetesës, me rritjen e çmimeve, të karburantit, me një jetë të papërballueshme dhe të pajetueshme në këtë vend.

Çfarë kërkojnë? Edhe kërkesat i kanë shtrirë në kohë, sepse janë intelektualë dhe e kuptojnë vështirësinë me të cilën përballen vendi dhe krizën ekonomike. Kërkojnë që të kenë 30% rritje të pagës këtë vit. Imagjinoni sa larg pritshmërive dhe kërkesave të tyre është 7- përqindëshi i premtuar nga qeveria! “Kurse pjesën tjetër ta gjejnë vetë universitetet!”, tha. Universitetet u

përballën me dy vjet pandemi, u përballën me mbylljen e degëve, me largimin e studentëve dhe me boshatisjen e auditorëve. Pedagogët kërkojnë të rritet financimi për kërkimin shkencor, dhe kjo duhet të ndodhë urgjentisht, duhet që nga 0,1% të PBB-së, që është sot, të shkojë minimalisht në 0,3%; të kthejmë auditorët dhe universitetet tona në qendra kërkimore të dijes dhe jo në vende ku pedagogët janë të keqpaguar e ku mundësitë e studimit nuk janë dhe aq të mira.

Por a janë paratë? Po, janë, dhe kur thonë që nuk ka para, gënjejnë. 400 milionë euro plus ka përfituar buxheti nga rritja e çmimeve. Ndërkohë që qeveria pasurohet, shqiptarët, pedagogët, pensionistët, shtresa e mesme po varfërohen. Kulmi i arrogancës së kësaj qeverie është kur i gjen paratë për një instalacion 3,7 milionë euro për qejfet e Kryeministrit, kur pedagogët, pensionistët dhe të varfrit përballen me luksin për të blerë fruta, me luksin për t'u ushqyer. Ky është kulmi i arrogancës në këtë kohë krize ekonomike dhe financiare të qytetarëve. Nga të dhënat e përpiluara, por edhe ato me të cilat do të përballemi në javët në vijim, përshkallëzimi i protestës nga pedagogët do të sjellë një kolaps të vitit të ri akademik. Prandaj do të duhet të ndryshojë qasja e kësaj qeverie ndaj pedagogëve.

Të ulen, të diskutojnë dhe të plotësojnë kërkesat e tyre, në të kundërt, në datën 17 tetor, nuk do të kemi fillim të vitit të ri akademik. Unë shpresoj që, kur një qeveri është të pakën përballë trupës intelektuale akademike, të ketë një qasje tjetër. Ka shumë prej nesh këtu që japin mësim në fakultet, disa kanë qenë pedagogë, dhe kjo qasje nuk i bën aspak nder vendit tonë. Pedagogët janë në të drejtën e tyre për të protestuar dhe janë një shembull i jashtëzakonshëm për studentët, sepse ne nuk japim vetëm leksione në auditorë, por, mbi të gjitha, nxjerrim individë të angazhuar dhe shembulli i tyre për të kërkuar të drejtat e tyre është shembulli më i mirë që mund të japin. Çfarë ndodh me mësuesit? Edhe me ta gjendja është tejet e rënduar.

Sipas të dhënave të përpiluara nga Komisioni Europian, paga e mësuesit shqiptar renditet e fundit në Europë, me rreth 4 mijë e 233 euro në vit, shumë më pak se të ardhurat vjetore në Maqedoninë e Veriut, në Bosnje Hercegovinë, në Serbi dhe në Malin e Zi. Pedagogët kërkojnë paga si kolegët e tyre në Kosovë, me kërkesa shumë modeste në krahasim me buxhetet respektive të të dyja qeverive. Ndërkohë, Kryeministri Kurti thotë që do të ndërpresë investimet

strategjike dhe do të investojë në paga, në edukim, sepse prioritet kombëtar për një vend nuk mund të jetë asgjë tjetër më tepër se arsimi. Faktikisht, kjo duhet të jetë qasja e çdo qeverie të përgjegjshme. Por çfarë ndodh? Kjo qeveri e ka shkurtuar buxhetin për arsimin në mars të këtij viti me paketën e parë të rezistencës, 15 milionë euro. E kemi denoncuar. Edhe unë e kam denoncuar në këtë foltore.

Ky veprim tregon qasjen e kësaj qeverie me arsimin, që nuk e ka aspak prioritet. Çfarë do të ndodhë me studentët që do të fillojnë vitin e ri akademik? Në paketën e fundit të rezistencës nuk ka buxhet për studentët. Qeveria i injoron, nuk e njeh këtë shtresë të shoqërisë, të cilët sot po përballen me qiratë e shtëpive të paktën 300 euro afër auditorëve dhe mjediseve të tyre të studimit, që është kosto shumë e larta për familjet e tyre. Si ka mundësi që nuk kemi një zë për këtë shtresë të shoqërisë, për studentët, ndërkohë që janë shtresa më vulnerabël e shoqërisë, sepse edhe janë në treg pune, edhe nuk janë në treg pune.

Nga ana tjetër, të rinjtë nuk po zgjedhin Shqipërinë, por zgjedhin të largohen në një eksod masiv. Ne duhet të reflektojmë për gjendjen ku ndodhet vendi. 11 mijë e 37 gjimnazistë kanë aplikuar për studime jashtë vendit. Sot kemi 50 mijë studentë më pak se 8 vjet më parë. Në vitin 2018 u mbyllën 41 degë studimi në të gjithë Shqipërinë. Në Universitetin e Gjirokastrës janë ¼-ta e studentëve më pak se në vitet e kaluara.

Të nderuar kolegë,

Kjo situatë duhet parë në sy, nuk duhet fshehur e vërteta. E vërteta është se zhvillimi nuk vjen nga krimi, nga koncesionet apo nga PPP-të, por duke investuar në arsim, duke e shpallur arsimin prioritet kombëtar, duke e buxhetuar, duke mbështetur pagat e pedagogëve dhe duke mbështetur studentët në këtë kohë krize shumë të thellë. E vetmja mënyrë për të ndaluar situatën ku ndodhemi është që arsimi dhe edukimi të jenë prioritete kombëtare.